



Агенција за вработување на
Република Македонија

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimit gjatë vitit 2012, të parapara me Programin e Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë 2011 – 2015, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, më **17.01.2012**, bën

SHPLLJE PUBLIKE

për

personat e papunësuar

1. U bën thirrje të gjithë personave të evidentuar si të papunësuar, të cilët janë:

- persona të evidentuar si të papunësuar më tepër se gjashtë muaj;
- persona të papunësuar nga fusha e energjetikës që dikur u është ndërprerë marrëdhënia e punës për arsye afariste;
- ushtarë profesionistë të cilëve u është ndërprerë shërbimi në ARM;
- persona të rinj deri në moshën 27 vjet;
- shfrytëzues të pagesës kompensuese në bazë të papunësisë.

dhe të cilët punësimin e tyre duan ta zgjidhin me mbështetjen financiare nëpërmjet **Programit të vetëpunësimit**, që të paraqiten në klubet e punës së qendrave të punësimit të APRM-së, ku rregullisht evidentohen si persona të papunësuar.

2. Mbështetja financiare përfshin pagesën e mjeteve të pakthyeshme për furnizimin me pajisje ose repromateriale në një shumë prej 185.000 denarësh dhe ndihmën e harxhimeve për regjistrimin e firmës.

3. Personat sipas pikës 1 të kësaj shpalljeje publike, të cilët janë themelues të firmës dhe të cilët do të mbështeten financiarisht, së paku katër vjet nuk mund të evidentohen si persona të papunësuar në APRM. Në qoftë se e ndërpresin ushtrimin e veprimtarisë (dhe bashkë me këtë e ndërpresin edhe marrëdhënien e punës) para se të kalojë një vit nga data e regjistrimit të biznesit, ose në qoftë se e ndërpresin vetëm marrëdhënien e punës, ndërsa në vendin e tij nuk punësohet menjëherë ndonjë person tjetër, ka obligim që t'i kthejë 80 për qind të mjeteve financiare që i ka shfrytëzuar për furnizimin me pajisje ose për repromateriale në formë të parave, në një periudhë prej 12 muajsh.

4. Personat e papunësuar sipas pikës 1 të kësaj shpalljeje publike, të cilët janë të interesuar, fletëparaqitjet e tyre mund t'i dorëzojnë deri më 31.01.2012 në klubet e punës së 30 qendrave të punësimit në RM.

5. Kushtet, të drejtat dhe obligimet më konkrete do të rregullohen me nënshkrimin e marrëveshjes së personave të papunësuar me APRM-në dhe UNDP-në.

Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e punës së 30 qendrave të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, në qendrën konstaktuese 02/3298-297 dhe ueb faqen www.avrm.gov.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT

E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË